



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO**

**QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT**

**MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM / MINISTARSTVO ZA ZAJEDNICE I POVRATAK / MINISTRY OF  
COMMUNITIES AND RETURNS**

## **STRATEGJIA PER KOMUNITETE DHE KTHIM**

**2009-2013**

## PERMBAJTJEN

I. HYRJE .....	5
II. METODOLOGJIA E FORMULIMIT TE STRATEGJISE.....	6
III. VIZIONI DHE SYNIMET .....	12
IV. KTHIMI I QENDRUESHEM.....	13
V. KOMUNITETET PAKICE- RREGULLAT JURIDIKE DHE ZBATIMI I TYRE .....	19
VI. KOMUNITETET PAKICE- ZHVILLIMI EKONOMIK.....	21
VII. DREJTIMI DHE IMPLEMENTIMI.....	24
VIII. KONKLuzionET.....	31
INSTRUMENTET JURIDIKE .....	32

## SHKURTESAT / AKRONIMET

IE	Integrimi Evropian
BE	Bashkimi Evropian
VShI	Vizita "Shko-informo"
VShSh	Vizita "Shko-shif"
PZhBV	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
PZhBPV	Personat e Zhvendosur Brenda Përbrenda vendit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MPM	Ministria e Punëve të Brendshme
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MAP	Ministria e Administratës Publike
MTT	Ministria e Transportit dhe Telekomunikimit
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MShP	Ministria e Shërbimeve Publike
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MEM	Ministria e Energjetikës dhe Minierave
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MAPH	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor
MAPZhr	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OJQ	Organizata Jo-qeveritare
GPK	Grupi Punues Komunal
RAE	Komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptas
GPR	Grupi Punues Rajonal
KE	Këshilli i Evropës
ZKRK	Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës
KB	Kombet e Bashkuara

UNHCR	Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNSCR	Rezoluta e Këshillit të Sigurisë Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara

## I. HYRJE

Strategjia e Qeverisë për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim definon një kthim të qëndrueshëm dhe zhvillim të të gjitha komuniteteve në terma afatgjatë: procesin gjithpërfshirës që ka ndikim në të gjitha aspektet e jetës (ekonomike, shoqërore dhe institucionale) në të gjitha nivelet. Kthimi i qëndrueshëm dhe zhvillimi nënkupton zhvillimin e një modeli, që në mënyrë kualitative përmbushë nevojat shoqërore-ekonomike, dhe interesat e qytetarëve. Një nga synimet kryesore të kthimit të qëndrueshëm është mundësia e punësimit, si dhe zvoglimi i jobarazisë shoqërore në grupet e marginalizuara. Programet për zhvillimin e mundësive të punësimit fillimisht duhet të synohen tek grupet më të pambrojtura, por gjithashtu duhet të jenë jo-diskriminuese ndaj grupeve tjera. Kushtetuta në nenet 57-62 paraqet strukturën ligjore të këtyre aktiviteteve.

Synimi i kësaj strategjie është që të nënvizoj politikat që Ministria për Komunitete dhe Kthim do t'i ndjekë për të balancuar dy elementet kyçe; stabilizimin e komuniteteve dhe kthimin e qëndrueshëm në Kosovë. Me këtë, bëhet përpjekja për balancimin e dëshirës për zhvillim shoqëro-ekonomik, nënvizohen përgjegjësitë që kanë institucionet e ndryshme, dhe rekomandohet një sistem i bashkëpunimit reciprok. Kjo është arritur duke marrë parasysh të gjitha këshillat dhe sygjerimet që kanë të bëjnë me faktorët e përfshirë.

Kjo strategji rrjedhë nga përgjegjësitë e dhëna, Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, sipas mandatit të saj. Në vijim duhet ri-theksuar se Qeveria është e përkushtuar ndaj procesit të plotë të Integritimit në Bashkimin Evropian. Në një të ardhme, Kosova, së bashku me vendet e tjera të Ballaknit Perëndimor dëshirojnë t'i bashkohen Bashkimit Evropian, që si rezultat ka perparësitë dhe përgjegjësitë e caktuara.

Kjo strategji detajon kërkesat për specifikacionet e promovimit të një komuniteti të tillë; multi-etnik si dhe detaje të tilla të intervenimeve të propozuara nga Qeveria.

Në përpilimin e prioriteteve të politikave të përfshira në këtë dokument, ministria ka zhvilluar konsultime të gjera si me ekspertë vendor ashtu edhe me ata ndërkombëtarë si dhe ka kryer hulumtime të veta; analiza në terren dhe vizita studimore. E gjithë kjo ka ndihmuar në formulimin dhe paraqitjen e një kuptimi më të mirë të çështjeve të përfshira në strategji.

Për këtë, Ministria dëshiron t'i falenderojë të gjithë ata që kanë dhënë kohën dhe ekspertizën e tyre në këtë proces.

## II. METODOLOGJIA E FORMULIMIT TE STRATEGJISE

Në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim është formuar Komisioni për përpilimin e Strategjise ne Gusht të vitit 2008. Ky Komision ka punuar për së afërmi me projektin e financuar nga Komisioni European në zhvillimin e kësaj strategjie. Projekti ka ofruar ndihmë në konceptim, në çështjet e përfshira gjatë përpilimit, ku kanë organizuar vizita në qytetin Bolzano në Itali, Kroaci dhe Bosnje dhe Hercegovinë për të parë se si operojnë marrëdhënjet në mes të komuniteteve/minoriteteve si dhe diferencimi i detajeve të sistemeve të përfshira në politikat e integruara në mënyrë të suksesshme të procesit të kthimit.

Gjatë fazës së parë të krijimit të strategjisë, shumë palë të interesuara; vendore dhe ndërkombëtare, janë njoftuar me konceptin bazë të nevojës për një strategji.

Në përpilimin e strategjisë, komisioni është bazuar në të gjitha dokumentet e qeverisë si dhe strategjitë që përfshijnë komunitetet dhe kthimet, në mënyrë që të vendosë drejtimin e saj. Si pasojë, është vendosur të bëhet unifikimi i dy komponenteve kyçe të kësaj strategjie- komuniteteve dhe kthimeve. Përderisa komisioni pranon se, strategji të tilla mund të kenë përfituar nga ekzistimi i një strategjie të përgjithshme për komunitete dhe kthim, përderisa Qeveria beson se ky dokument paraqet drejtimin dhe kornizën e përgjithshme politike në këtë drejtim. Si e tillë, kjo strategji ofron një përmbledhje të politikave dhe udhëzimeve ku të gjithë strategjitë tjera janë pjesë e saj.

Për më shumë, komisioni ka qenë i informuar rreth procesit të përgjithshëm të formulimit të strategjive të cilat po përgaditen dhe zbatohen përgjatë të gjitha ministrive të qeverisë, agjensioneve dhe komunave.

Gjatë përpilimit të kësaj strategjie janë zhvilluar shumë konsultime me burimet statistikore dhe burime tjera. Ky komision është mëse faleminderues UNHCR-it për të dhënat statistikore në fushën e kthimeve dhe anketave lidhur me kushtet shoqrore-ekonomike (nevojat e komuniteteve) në Kosovë, të kryera përmes projektit ZNKE. Përveç kësaj, shumë nga studimet lidhur me komunitetet në Kosovë janë përdorur si mjete analitike dhe dokumentuese. Ministria, dëshiron të faleminderoj të gjithë ata që kanë qenë pjesëmarrës në hulumtimin dhe analizimin e sektorit të komuniteteve dhe kthimeve në Kosovë.

Si pjesë e ushtrimit konsultativ një numër i institucioneve të qeverisë, ministritë relevante, komunat si dhe partnerët ndërkombëtarë kanë ofruar kontributin e tyre në përpilimin e strategjisë. Edhe partnerët vendor kanë qenë të kyqur në këtë proces, ku qeveria dëshiron t'i falenderoj të gjithë ata që kanë kushtuar kohën e tyre në ndihmën për zhvillimin e kësaj strategjie.

Si pjesë e procesit të krijimit të strategjisë, nën mbështetjen e projektit të financuar nga ZNKE kemi organizuar një konferencë mbi politikat lidhur me minoritetet në Kosovë- Zhvillimi i Strategjisë dhe Formulimi Institucional. Një

numër i madh i partnerëve vendor dhe ndërkombëtarë morrën pjesë në këtë konferencë, ku u shkëmbyen idetë dhe kushtet e komuniteteve, dhe ku është diskutuar më gjërë për procesin e kthimit në Kosovë.

Në Mars 2009, u organizua një takim pune sërish me mbështetjen e projektit të financuar nga ZNKE, ku pjesëmarrësit e institucioneve kyçe qeveritare të përfshirë në sektoret e komuniteteve dhe kthimit kishin mundësi të mblidheshin së bashku dhe të finalizojnë punën lidhur me drejtimin e politikave. Gjithashtu, gjatë muajit prill dhe maj, ministria, ka zhvilluar konsultime të gjera me akterët kyç për të siguruar se partnerët e saj ndajnë së bashku vizionin e politikave dhe udhëzimet përkatëse.

Duam të përsërisim edhe një herë se, Kushtetuta e Kosovës mbetet dokumenti udhëzues për këtë strategji. Ligjet relevante që dalin nga Kushtetuta përcaktojnë rolin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, si pjesë e trupit që punon në përcaktimin e politikave në fushën e komuniteteve dhe kthimit dhe se qeveria merr përgjegjësi të plotë rreth përcaktimit dhe implementimin relevant të kësaj strategjie.

### **Përgjegjësitë e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim**

Ministria për Komunitete dhe Kthim është themeluar më 24 Janar 2005, me emërimin e Ministrit duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/50 të datës 2 Dhjetor 2004. Në atë kohë të gjitha kompetencat dhe dokumentacioni u transferuan nga Zyra për Komunitete dhe Kthim brenda Zyrës së Kryeministrit tek Ministria për Komunitete dhe Kthim. Me krijimin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, u punësuan 287 puntorë që i përkisnin të gjitha komuniteteve nacionale. Sot Ministria për Komunitete dhe Kthime ka të punësuar 100 zyrtarë nga gati të gjitha komunitetet nacionale.

Mandati i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim përmbanë pikat në vazhdim:

- Zhvillon politikat dhe promovon zbatimin e rregullave ligjore për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të saj, duke e përfshirë të drejtën në të kthyer, në pajtim me Kushtetutën e Kosovës.
- Promovon nderlidhejen e kushteve të volitshme për kthim dhe siguron casejen e kthimit të bazuar në ligje.
- Siguron udhëheqjen pranë ndertimit të besueshmerisë, me aktivitetet e dialogut dhe të pajtimit në mes të komuniteteve si dhe të perkrahejes mbi zbatimin e aktivitetëve të tilla.

- Zhvillon dhe mbikqyre zbatimin e Strategjise se Qeverise mbi ofrimin e komuniteteve dhe kthimit si dhe perkrah zhvillimin dhe zbatimin e strategjive te tilla ne te gjitha komunat .
- I zhvillon ose i drejton programet dhe mekanizmat e lehtesimit per lehtesimin e e riintegrimin te barabarte tek te gjitha komunitetet dhe te pjestareve te tyre te cilet per momentin akoma jetojne ne Kosove si dhe siguron kthim te qendrueshem per personat e shperngulur dhe per refugjate.
- Siguron qe politika ne nivelin qendror dhe lokal t'i kyq masat e mbrojtejes se te drjtave te komuniteteve, te drejtave te njeriut dhe interesave te te kthyerave, duke i kyqur ato ne lemire e qarkullimit te lire, perdorimit te gjuheve, lirise se te shprehurit, paraqitejes se pergjitheshme, arsimimit, punesimit dhe qasejes se barabarte te gjyqesise, vendosejes banesore si dhe te sherbimeve komunale .
- Perpilon rekomandimet dhe koordinon aktivitetet e ministrive, komunave dhe te institucioneve te tjera ne krahasim me promovimin dhe mbrojtejen e te drejtave dhe intereseve te komuniteteve dhe te pjestareve te tyre duke e perfshire edhe te drejten ne kthim.
- Mbikqyre dhe perkrah perpjekjet e komunes qe te inicon qeshtejen e komuniteteve dhe te kthimit, duke e kyqur ketu edhe punen e Komisionit per ndermjetesim, Komisionit per Komunitete, Zyrate Komunale per Komunitete si dhe zhvillimin dhe zbatimin e Strategjive komunale per Kthim.
- Rishikon dhe siguron ndihmen per ministrite e tjera ne krahasim me sjelljet dhe praktiken momentale si dhe propozon politika dhe projekte te rregullave ligjore me qellim te sigurimit qe te drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe te perfaqesueseve te tyre si dhe personat e shperngulur te jene ne teresi te rrespektuara si dhe institucionet ligjdhenese te veprojne ne ate menyre qe rregulativa komunale te jete ne pajtueshmeri me standardet adekuate Nderkombetare si dhe te rregullave te parapara ne Kushtetuten e Kosoves.

- Koordinon me ministrite, komunat dhe me institucionet tjera zhvillimin e pergjegjesive per nevoja humanitare te komuniteteve dhe te pjesetareve te tyre.
- Koordinon me ministrite, komunat dhe me institucionet tjera zbatimin e Strategjise per te drejtata e njeriut duke marrur para sysh sigurimin dhe te drejtat e pjesetareve te te gjitha komuniteteve, personave te shperngulur si dhe te te kthyerave te jene te promovuara dhe te mbrojtura me nje kujdes te posacem te kushtuar ndaj nevojave te femrave, te femijeve, personave te moshuar si dhe te grupeve te tjera te lenduara.
- Percjell dhe perkrah kornizen operative per kthim me qellim te sigurimit te qasejes se bazuar ne te drejtat te cilat iu pergjigjen nevojave te personave te shperngulur si dhe punon me ministrite e tjera, agjensionet dhe OJQ -te ne kete proces.
- Percjell harmonizimin e akteve ligjore dhe politikat e e ministrive te tjera si dhe te institucioneve lokale me Kushtetuten e Kosoves dhe ndermerr rolin udheheqes ne aksionet te cilat ministrise ia ndane Qeveria e Kosoves.
- Ndhmon zhvillimin dhe zbatimin e masave ne lemin e informimit te publikut si dhe te projekteve te tjera promovuese, ngritejen e nivelit te vetedijes se publikut mbi te drejtat dhe interesat e Komuniteteve si dhe te pjesetareve te tyre duke e inkuadruar te drejten e kthimit.
- Kryen edhe detyra te tjera te percaktuara me rregullat ligjore ne fuqi.

#### **FAKTORËT TË CILËT ÇAKTOJNË PUNËN E MINISTRISË**

Gjatë formulimit të strategjisë janë kryer analizat SWOT (PDMP). Kjo i mundësoi komisionit për strategji të MKK-së t'i shqyrtoj përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe pengesat që rrethojnë këto dy sektore si dhe pozicionin e ministrisë. Kjo siguroi një pikë-fillim nga e cila u zhvillua strategjia.

Përparësitë	Dobësitë
<p>Krijimi i bazës ligjore për një shoqëri demokratike;</p> <p>Rritja e besueshmërisë dhe bashkëpunimi më i mirë në nivel lokal;</p> <p>Bashkëpunimi i mirë me institucionet vendore dhe ndërkombëtare;</p> <p>Ngritja e vetëdijes për nevojat më të mëdha për fonde për zhvillimin e komuniteteve;</p> <p>Posedimi i informatave për procesin e kthimit;</p> <p>Decentralizimi.</p>	<p>Masat e pamjaftueshme për ngritjen e qëndrueshmërisë dhe reintegrimin e të kthyerëve;</p> <p>Pamundësia e kthimit të personave të zhvendosur dhe refugjatëve në shtëpitë e tyre (rastet specifike);</p> <p>Marrëdhënjet me partnerët;</p> <p>Kthimi dhe qëndrueshmëria e kthimeve;</p> <p>Gatishmëria e pamjaftueshme për bashkëpunim me disa nga komunitat;</p> <p>Identifikimi i problemeve në fushën e infrastruktures dhe rëndësisë së saj për komunitetet;</p> <p>Pamundësia e zgjidhjes së problemeve të identifikuara sa i përket kthimit të pronës dhe të drejtave të banimit;</p> <p>Qasja në shërbimet ligjore.</p>
Mundësitë	Pengesat
<p>Stabilizimi i komuniteteve përmes implementimit të projektit të MKK-së;</p> <p>Rritja e numrit të kthimeve të qëndrueshme;</p> <p>Sigurimi i fondeve më të mëdha nga BKK dhe nga donatorët;</p> <p>Pranimi i mirë i MKK-së tek komunitetet pakicë dhe të zhvendosurit;</p> <p>Roli udhëheqës i MKK-së në procesin e kthimit, integrimi i të kthyerëve dhe stabilizimi i komuniteteve;</p> <p>Planifikimi i mbikëqyrur, krijimi, dhe implementimi i menaxhimit të ciklit të projekteve;</p>	<p>Mos-aplikimi i ligjeve relevante;</p> <p>Trendet jo-favorizuese demografike;</p> <p>Ngritja e shkallës së papunësisë;</p> <p>Zvogëlimi i fondeve;</p> <p>Periudha e gjatë kohore për implementimin e kthimit.</p>

<p>Sigurimi dhe bashkimi i mjeteve për riparimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së rëndësishme për komunitetet;</p> <p>Bashkëpunimi më i mirë me institucionet relevante që janë përgjegjëse për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë;</p> <p>Motivimi i komuniteteve në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.</p>	
---	--

### III. VIZIONI DHE SYNIMET

Kjo Strategji drejtohet nga vizioni i përgjithshëm për të kontribuar drejt zhvillimit të një shoqërie multi-etnike, prosperuese dhe demokratike me të drejta të barabarta.

Për realizimin e këtij vizioni, strategjia fokusohet në tri synime primare që në veçanti janë komuniteti stabil, kthimi i qëndrueshëm dhe reintegrimi i personave të zhvendosur si dhe reintegrimi ekonomik i komuniteteve. Mundëson që drejtimi i politikave të strategjisë të sigurojë se ekzistojnë kushtet për kthim të qëndrueshëm, integrim në shoqërinë e Kosovës. Në bazë të kësaj rrjedhin përmirësime në fushat e mëposhtme:

#### I. Fuqizimi dhe Stabilizimi i Komuniteteve ne Kosovë

- Fuqizimi i të drejtave të komuniteteve dhe të sigurohet zbatimi i ligjit aktual për Mbrojtjen dhe Promovimin e Ligjeve për Komunitetet
- Të sigurohet pjesëmarrja shoqërore dhe qasja e komuniteteve në të gjitha shërbimet publike

#### II. Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur nga Kosova

- Të sigurohet mbështetje për të gjithë të kthyerit në Kosovë
- Të sigurohet se personat e zhvendosur dhe të kthyerit potencial të kenë informacione adekuate rreth kushteve të kthimit dhe të drejtave të tyre
- Të sigurohen kushte adekuate në vendin e kthimit për kthim të qëndrueshëm dhe integrimin e të kthyerve.

#### III. Mbështetja për zhvillim ekonomik të komuniteteve në Kosovë, si një parakusht kryesor për stabilizimin e komuniteteve dhe kthimit të qëndrueshëm

- Sigurimi i mundësive të barabarta për zhvillimin e të gjithë komuniteteve
- Sigurimi i alokimit të mjeteve të projekteve të cilat plotësojnë kushtet për stabilizim dhe integrim të komuniteteve

Synimi i tretë drejtohet kah përmirësimi i kushteve ekonomike dhe integrimi i komuniteteve, duke përfshirë personat e kthyer në mënyrë që të promovohet një shoqëri stabile, prosperuese dhe multi-etnike në Kosovë.

## IV. KTHIMI I QENDRUESHEM

### Situata aktuale

Më pak se 20,000 persona nga komunitetet pakicë janë kthyer në Kosovë që nga konflikti i vitit 1999. Deri në vitin 2006, komuniteti ndërkombëtarë ka bërë organizimin e procesit të kthimit. Përgjatë këtyre dy-tri viteve të fundit, implementimi i politikave ka rënë në duar të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Disa dokumentet dhe drejtimet janë zhvilluar gjatë disa viteve të fundit për vendosjen e standardeve dhe verifikimin e mekanizmave për mbështetjen e procesit të kthimit në Kosovë. Aktualisht dokumentet e vlefshme të udhëhequr nga „Protokoli i kthimit të qëndrueshëm dhe vullnetarë” (Qërshorë 2006) dhe “Doracaku i Reviduar për kthim të qëndrueshëm” (Qërshorë 2006).

Dhe pranë mekanizmave të zhvilluar dhe ndihmës së partnerëve, reluztatët në procesin e kthimit në Kosovë deri më tani nuk ishim të kënaqshëm. Vetëm një përqindje e vogël e të zhvendosurve është kthyer në Kosovë dhe kanë gjetur zgjidhje afatgjata.

Personat e zhvendosur nga Kosova ndahen në këto kategori<sup>1</sup>:

- a) Personat e zhvendosur brenda vendit (PZhBV)
- b) Personat e zhvendosur brenda përbrenda vendit (PZhBPV)
- c) Refugjatët (R)

### Definicioni:

**Personat e zhvendosur brenda vendit** janë individë që janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre për shkak të konfliktit të armatosur, shmangjes së konfliktit të armatosur, situatës së dhunës në përgjithësi, dhunimit të të drejtave njerëzore, për shkak të fatkeqësive natyrore apo atyre artificiale dhe ata të cilët nuk kanë kaluar kufinj të njohur ndërkombëtarisht<sup>2</sup>. Kur flasim për Kosovën, këta janë individ dhe familje të cilët jetojnë brenda kufinjëve të Serbisë dhe Malit të Zi (përderisa Serbia dhe Mali i Zi ishin ende një shtet dhe derisa Kosova shpalli pavarësinë e saj).

**Personat e zhvendosur brenda përbrenda vendit** janë individët apo grupet që janë zhvendosur (nuk jetojnë në vendet ku kanë jetuar para konfliktit apo pas

---

<sup>1</sup> Doracaku i Reviduar për Kthim të Qendrueshëm, Qershorë 2006. Prishtinë.

<sup>2</sup> Parimi udhëzues i KB-se lidhur me shpërnguljen interne, pika 2, hyrje – Qellimi – Faqe 10

konfliktit, të cilët u detyruan të lëshojnë vendin e tyre) por momentalisht jetojnë brenda kufinjëve të Kosovës.

**Refugjatët** janë persona të vendosur jashtë kufinjëve të shtetit të tyre nacional apo vend-qëndrimit, të cilët kanë frikë nga persekutimi për shkak të racës së tyre, religjionit, nacionalitetit, përkatësisë në ndonjë grup shoqëror, apo të ndonjë opinioni politik, dhe të cilët nuk dëshirojnë të mbrohen nga shteti, apo të kthehen për shkak të frikës nga persekutimi, dhuna dhe kërcënimet nga entitetet federale apo jo-federale apo individët.

Personat e Zhvendosur nga Kosova në Maqedoni dhe Mal të Zi nuk kanë statusin zyrtar të refugjatëve edhe pse janë të zhvendosur përgjatë kufinjëve. Ata të gjithë quhen Persona të Zhvendosur<sup>3</sup>.

Është e vështirë të llogarisin numrin e saktë të refugjatëve dhe të zhvendosurve. Sipas të dhënave të UNHCR-it, të cilit janë të dhënat e vetme zyrtare numri i përafërt është rreth 200,000 të zhvendosurve nga Kosova të zhvendosur në Serbi, Mal të Zi, Makedonji dhe brenda Kosovës.<sup>4</sup>:

Kushtetuta dhe legjislacioni relevant së bashku me planin e Ahtisarit i adoptuar nga qeveria, thekson në mënyrë të qartë thekson se të gjithë refugjatët dhe PZhBV nga Kosova kanë të drejtën e kthimit në shtëpitë e tyre dhe riparimin e pronave të tyre. Qeveria ka deklaruar se kthimi i refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit është një nga parimet kryesore që paraqesin themelin e një shoqërie demokratike dhe multi-etnike. Qeveria mbetet plotësisht e përkushtuar për këtë parim.


**Tabela 1. Mbikëqyrja e të Kthyerve 2000-2009 (Shtatore)**

Grupi etnik	KTHIMI I KOMUNITETEVE PAKICE NE KOSOVE NE PERIUDHEN 2000 – SHTATOR 2009											
	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	Total	%
Serbet	1,826	679	966	1550	818	740	615	585	231	248	<b>8,294</b>	42.64
Rom	20	214	390	287	430	235	303	581	86	187	<b>2,733</b>	14.05
Ashkali Egjiptas	0	533	882	1182	593	727	466	312	195	123	<b>5,013</b>	25.78
Boshnjak	57	0	149	393	479	250	93	89	39	36	<b>1,585</b>	8.15
Goran	3	0	73	145	141	125	139	234	85	83	<b>1,028</b>	5.29
Shqiptare	0	27	249	245	8	49	53	15	43	62	<b>796</b>	4.09
<b>Total</b>	<b>1,906</b>	<b>1,453</b>	<b>2,754</b>	<b>3,801</b>	<b>2,469</b>	<b>2,126</b>	<b>1,669</b>	<b>1,816</b>	<b>679</b>	<b>775</b>	<b>19,449</b>	<b>100.00</b>

<sup>3</sup> Ne pajtim me nenin 1 te Konventes se Gjeneves lidhur me refugjatet qe nga viti 1951.

<sup>4</sup> Burimi: UNHCR, 2000/2009

**Diagram 2: The total number of returnees by communities (2000-2009)**



Burime nga: UNHCR, 2009

Tabela dhe diagrami tregojnë gjendejen e përgjithshme dhe zhvillimin e procesit të kthimit që nga viti 2000 deri 2009 dhe numrin e të kthyerve sipas komunitetit.

Në pajtim me mekanizmat e aplikueshëm dhe definicionet në fuqi, ekzistojnë katër kategori të gjera të të kthyerëve në Kosovë, të cilët janë:

**a) Kthimi Spontan (Individual)**

Individët, familjet apo grupet që janë kthyer pa ndonjë paralajmërim paraprak dhe që nuk kanë marrë ndonjë ndihmë materiale para kthimit të tyre apo nuk kanë planifikuar kthimin e tyre më herët.

**b) Kthimi i asistuar**

Bazuar kërkesat individuale nga personat e zhvendosur, familjet apo grupet relativisht të vogla të të kthyerëve, u është siguruar asistencë para, gjatë dhe pas kthimit, zakonisht përmes komunave apo OJQ-ve përmes programeve tashmë të themeluara.

### c) Kthimi i Organizuar

Ky kthim është i planifikuar dhe posedon pakon asistuese të plotë para kthimit, është pjesë e projektpropozimeve dhe grumbullimit të mjeteve financiare në mënyrë që të plotësohen nevojat bazike. Veprimet si: parashikimet, zhvillimet, aplikimet; ndjekin dhe janë zakonisht të koordinuara në pajtim me Manualin për Kthim të Qëndrueshëm.

### d) Kthimi i Detyruar (Deportimi)

Individët, familjet, grupet, të cilëve statusi si refugjatë i'u është refuzuar në vendet e treta (ky lloj kthimi është nën ombrellën e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Zyrës së Kryeministrit)

Këto definicione mund të ndryshojnë gjatë vitit 2009, sipas ndryshimeve në mekanizmat e kthimit që do të kryhen nga ana e MKK-së gjatë përgatitjes së kësaj strategjie.

## Analizat

Në periudhën janar-dhjetor të vitit 2007, janë kthyer 1,816 persona, për periudhën e njejtë në vitin 2008 janë kthyer gjithësej 679 persona të zhendosur në Kosovë. Këto shifra përfaqësojnë një trend të rënjes së numrit të të kthyerëve. Të gjitha analizat tregojnë se edhe në vitin 2003, vit me numrin më të madhë të të kthyerëve nuk tejkalohet shifra prej 3,801 personash. Për këtë, prej numrit potencial prej 250,000 personash, asnjë nga institucionet përgjegjëse nuk mund të tregojnë një sukses të veçantë në procesin e kthimit të komunitetit pakicë.

Në Maj të vitit 2008 OCM/UNHCR në Kosovë ka publikuar një dokument lidhur me kthimin e qëndrueshëm. Qëllimi i këtij dokumenti është vlerësimi i kthimit të qëndrueshëm për komunitetet pakicë në Kosovë. Hulumtimi ka përfshirë 5,632 intervista me të kthyerit nga Marsi i vitit 2005 deri në Prill të vitit 2008. Janë arritur tri zbulime kryesore.

- Nga 5,632 njerëz të intervistuar, 84.45% apo 4,756 të kthyer ende jetojnë në vendet ku janë kthyer.
- Hulumtimi gjithashtu ka treguar se kthimi individual është më i qëndrueshëm: 94.0% e të kthyerëve individual ende jetojnë në vendet që janë kthyer. Edhe pse më shumë fonde janë shpenzuar në kthimin e organizuar, tregohet të jetë një nga kthimet më pak të qëndrueshme. Sidoqoftë, 74.5% të njerëzve jetojnë në vendet ku janë kthyer.
- Në Kosovë ende mbeten rreth 20,000 persona të zhvendosur. Një numër i konsiderueshëm i tyre ende jetojnë nëpër qendra kolektive. Këto qendra

janë ndërtesa që janë modifikuar në shpejtësi për këtë qëllim, siq janë shkollat e vjetra, shtëpitë e kulturës, barakat, qendrat shëndetësore etj, po ashtu edhe ndërtesat e liruara siq janë hotelet, motelet. Niveli i kualitetit të akomodimit është shumë i ulët.

### **Prioritetet për reformë**

Ministria dëshiron të forëcoj procesin e kthimit. Në këtë drejtim si prioritare konsiderohen pesë kategoritë në vijim:

- I. Krijimi i një mekanizmi të përmirësuar dhe thjeshtësuar të kthimit
- II. Mekanizmi i ri për kthim dhe informimi i personave të zhvendosur për kushtet në Kosovë
- III. Pako totale të ndihmës për të kthyerit do të ngrihet sipas standardeve të pranuara
- IV. Zgjerimi i grupit të perfituesve për ndihma gjatë kthimit dhe fokusimi në ndihma për familjet të cilat janë të shpërngulura dhe jetojnë në qendra kolektive me qëllim të gjetjes së zgjidhjes afatgjate
- V. T`i ipet prioriteti kthimit në zonat urbane (vendet në të cilët është e disponueshme shkolla, struktura shëndetësore, etj. Vendet në të cilët ekzistojnë niveli i caktuar i infrastrukturës)

#### **I. Eshtë vuar dhe përmirësuar dhe thjeshtësuar mekanizmi për kthim**

Në fund të vitit 2008, rishikimet në manualin për kthim të qëndrueshëm kanë filluar me idenë që procesi i kthimit të kryhet në mënyrë më të lehtë dhe më të shpejtë. Gjatë vitit 2009 është është vazhduar në revidimin e Manualit, dhe ministria në bashkëpunim me komunat dhe partnerët relevant bënë hulumtimin e metodave për të lehtësuar veprimet dhe që të sigurojë një ndarje të qartë të përgjegjësisë në mes të nivelit qendrorë dhe lokal të qeverisë. Ministria beson se procedurat janë ende të komplikuar dhe duhet të qartësohen. Pasi që ministria të zhvillojë procedurat e reja, në bashkëpunim me komunat dhe partnerët relevant, do t`i testoj ato gjatë pjesës së fundit të vitit 2009, me shpresë që do t`i implementojë plotësisht përgjatë Kosovës në vitin 2010.

#### **II. Informimi i personave të zhvendosur rreth mekanizmit për kthim**

Pas vendosjes së mekanizmave të rinjë do të paraqitet kërkesa për sistem të ri për të kthyerit potencial. Ministria do të sigurojë të gjitha kushtet e nevojshme për paraqitjen e këtij mekanizmi gjithashtu do të revidojë politiken e saj sa i përket

komunikimit. Gjithashtu do të adoptohen sisteme për monitorimin e efektshmërisë së dhenave të paraqitura.

### **III. Gjithesej paketat e ndihmes për të kthyerit do të krijohet sipas standardeve të unifikuara**

Ministria dëshiron të siguroj se çështja e banimit, edhe nëse kanë të bëjë me rindërtimin dhe ndërtimin e banesave të reja të bëhen sipas standardeve të pranueshme. Udhëzimet për kualitet dhe kuantitet janë pjesë e manualit të rishikuar për kthim të qëndrueshëm. Ministria me krijimin e njësisë së monitorimit do të tentoj të siguroj se të gjitha projektet e financuara nga ana e ministrise të zbatohen sipas standardeve pranuar.

### **VI. Zgjerimi i grupeve të perfituesve për ndihma gjatë kthimit dhe fokusimi në ndihma për familjet të cilat janë të shperngulura dhe jetojnë në qendrat kolektive në qellim të gjetjes së zgjidhjes afatgjate**

Ministria do të ofron mekanizma mbështetës për PZHI dhe PZHII dhe të cilet deshirojnë që të kthehen në vendet e tyre të prejardhjes, aty ku kanë pronën, që të sigurohet mbështetja për PZHII-te të cilet deshirojnë të integrohen nga vendet e shpernguljes brenda Kosovës dhe gjithashtu të sigurohet ofrimi i ndihmes për PZHI dhe PZHII-te të cilet nuk kanë fare pasuri. Në pajtim me nevojat e paraqitura për shfrytëzuesit momental të qendrave kolektive, Ministria do të përpilon programe dhe projekte të cilat për qëllim do ta kenë ndërprerjen e mënyrës së tillë të banimit.

### **V. Kthimi i të zhvendosurve në mjediset urbane**

Ministria dëshiron të inkurajoj ku është e mundur që personat e zhvendosur të kthehen në zonat ku tashmë kanë një infrastrukturë, në terma të shkollave, shërbimeve shëndetësore dhe të tjera. Kjo nuk bëhet për arsye të çenimit të drejtës për t'u kthyer në vendin e origjinës, por për shkak se do të ishte e arsyeshme që të kthehen në një vend ku tashmë ekzistojnë disa kushte bazike shoqërore. Gjithashtu edhe mundësitë për punë mund të jenë më të mëdha në vendet më urbane apo ato tashmë të ndërtuara në Kosovë. Në të njëjtën kohë, qeveria, dëshiron të shoh mbylljen e të gjitha qendrave kolektive dhe zgjidhjen e problemeve të akomodimit kolektiv gjatë periudhës së këtij plani strategjik.

## V. KOMUNITETET PAKICE- RREGULLAT JURIDIKE DHE ZBATIMI I TYRE

### Situata ekzistuese

Kosovës i mungojnë të dhënat e azhuruara demografike (numri i banorëve, numri i njerze të komunitetit pakicë, distribuimi gjinor, shkalla e lindjes dhe shkalla e vdekshmërisë, numri i besimtarëve nga religjionet e ndryshme etj).

Sipas të dhënave mesatare demografike nga Kombet e Bashkuara të vitit 2002, numri total i popullsisë është në mes të 1.7 dhe 1.9 milion. Kosova është plotësisht e përkushtuar në pranimin e multi-etnicitetit si parim kyç. Kushtetuta e re që hyri në fuqi më 15 Qershor 2008 siguroi një ndikim të madhë të komuniteteve në jetën publike. Ligji mbi Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjestarëve të tyre njeh të drejta substanciale për komunitetet. Njihen si grupe nacionale, etnike, kulturore, gjuhësore apo religjioze që janë prezente në Kosovë dhe nuk janë pjesë e shumicës.

Personat që u përkasin komuniteteve kanë të drejtën që së bashku me të tjerët t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë fundamentale njerëzore të përcaktuara nga aktet ligjore ndërkombëtare të cilat ushtrohen në Kosovë. Kushtetuta, ligjet dhe rregulloret tjera garantojnë këto të drejta dhe liri.

Sipas nenit 2.1,2.3 dhe 2.4 të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve nr. 02/L-37 të dates 27 Korrik 2006 „Gjuha Shqipe dhe Serbe si dhe alfabetete e tyre kanë status të barabartë në Institucionet e Kosovës“, „inë komunat ku banojnë nga një komunitet, gjuha e të cilit nuk është një nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe të cilët përfaqësojnë më shumë se 3 (tre) për qind të populates në komunë, gjuha dhe alfabeti i atij komuniteti do të ketë statusin e përdorimit të gjuhës zyrtare bë komunën përkatëse dhe do të përdoret në mënyrë të barabartë. Në komunat e banuara nga komunitetet, gjuha e amtare e të cilëve nuk është njëra nga gjuhët zyrtare por që kanë së paku 5 për qind të popullatës së komunës, gjuha e këtij komuniteti do të ketë statusin e gjuhës zyrtare dhe do të përdoret në mënyrë të barabartë me gjuhët tjera zyrtare. Pa marrë parasysh deklaratës më sipër, në veçanti në Komunën e Prizrenit, gjuha turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare.“<sup>5</sup>

### Analizat

Sfida kryesore është zbatimi në praktikë i masave mbrojtëse, të siguruara nga legjislati. Çështja kryesore për komunitetet pakicë është aftësia për të ushtruar

---

<sup>5</sup> Ligji i Kosoves per përdorimit te gjuheve nr. 2006/2 – L 37 miratuar me 27.07.2006

liritë e tyre duke përfshirë lirinë e lëvizjes, liria për t'u kthyer, tek përkatësia etnike, prona, banimi, zgjedhja e lirë e opsioneve të punësimit, përdorimi i gjuhës, qasja në arsim dhe shërbimet tjera publike.

Megjithatë, në praktikë si dhe nga shumë raporte informuese të partnerëve ndërkombëtarë, të drejtat e tilla nuk plotësohen në teresi. Në bazë të kësaj sfide kyçe, për qeverinë e Kosovës, si e përfaqësuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, është të shoh qartë rolin e saj.

Me gjithë përparimet e bëra nga ana e qeverisë së Kosovës, rezultatet mbesin më pak se të kënaqshme.

## **Prioritetet dhe reforma**

Prioritetet kryesore janë:

- I. Përmirësimi i kapacitetit për të zhvilluar dhe zbatuar ligjet, rregulloret dhe standardet në lidhje me sigurinë, arsimin, shërbimet shëndetësore dhe sociale dhe të përdorimin e gjuhës
- II. Rritja e vetëdijes në mesin e anëtarëve të komunitetit lidhur me vlerat e një shoqërie multietnike, demokratike, prosperuese, të barabartë dhe të sigurojë një përfaqësim të barabartë të të gjitha komuniteteve në jetën publike

Një detyrë mjaft e rëndësishme do të jetë ndërtimi i kapacitetit të institucioneve përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe standardeve në lidhje me sigurinë, arsimin, shërbimet shëndetësore dhe sociale dhe të përdorimi i gjuhës. Kjo do të kërkojë koordinim të catkuar midis institucioneve, si një çështje e domosdoshme që duhet të rregullohet.

Ministria së bashku me qeverinë (qëndrore dhe lokale) dhe institucionet shtetërore do të:

- i. Zhvilloj komunikimin dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe sektorin e drejtësisë.
- ii. Projekt propozimet lidhur me sigurinë tek Këshilli i Sigurisë së Kosovës
- iii. Bashkëpunoj me ministrinë përkatëse në arsim, shëndetësi dhe mirëqenje shoqërore
- iv. Fuqizimi i bashkëpunimit me ministrinë që kanë mandat të gjerë siq është ministria e financave, dhe ministria e qeverisjes lokale,
- v. Fuqizimi i bashkëpunimit me komunat

- vi. Fuqizimi i bashkëpunimit me agjencitë qeveritare në veçanti me zyrën e statistikave dhe Agjencinë Kosovare të Pronës
- vii. Rishikimi i efikasitetit të mekanizmave ekzistues për komunitetet dhe propozimi i mekanizmave efektive për bashkëpunim ndër-qeveritar.

Ministria në mënyrë specifike do të:

- i. Krijoj njësinë për planifikim apo krijim të politikave në ministri.
- ii. Inkurajoj pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në formulimin e politikave duke bashkëpunuar me Keshillin Konsultativ për Komunitete si dhe të hulumtoj dhe rekomandoj metoda për një komunikim më të mirë me komunitetet në nivel komunal.

Pa mbështetjen dhe mirëkuptimin e pjesëtarëve të komuniteteve lidhur me vlerat e një shoqërie multi-etnike, demokratike, prosperuese dhe të barabartë do të jetë e vështirë implementimi i politikave të mira dhe të sigurohet përfaqësim i barabartë i të gjitha komuniteteve në jetën publike. Ministria do të jetë aktive në krijimin e projekteve hulumtuese dhe do të përgatis raporte lidhur me çështjet e veçanta që kanë të bëjnë me komunitet pakicë. Do të organizoj dhe do të marrë pjesë në konferenca dhe ngjarje tjera politike si në Kosovë ashtu edhe në rajon për të promovuar bashkëpunimin. Këto aktivitete janë elementi thelbësor i një qeverisje të mirë, që siguron se politikat publike marrin parasysh nevojat që mund të përfshihen në progres, informim të ri dhe rrethana të ndryshueshme. Ministria në të ardhmen, do të punoj në forcimin e bashkëpunimit me Ministrinë e Administratës Publike dhe me agjencitë tjera të qeverisë siq janë Ombudspersoni dhe komisioni i mediave, për të promovuar implementimin proaktiv të politikave jo-diskriminuese dhe mundësive të barabarta të të gjitha komuniteteve pakice në shërbimet publike në të gjitha nivelet.

## **VI. KOMUNITETET PAKICE- ZHVILLIMI EKONOMIK**

### **Situata aktuale**

Duke vezhguar situatën gjenerale të komuniteteve të cilat jetojnë në Kosovë, ministria sheh si një ndër faktorët kyq të ekzistencës, faktorin ekonomik. Gjendja e vështirë ekonomike dhe shkalla e lartë e papunësisë ndikon në jetën e përditshme të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Numri i regjistruar i punëkërkuësve në Maj të vitit 2008 ishte 311,230. Përderisa rritja e BPV mund të jetë rreth 6% në vit sipas të dhënave të fundit, kjo vjen nga një bazë shumë e ulët. Situata

ekonomike përgjithësisht e varfër ndikon tek të gjitha komunitetet, por pjesëtarët e komunitetit pakicë ballafaqohen me limite shtesë në qasjen drejtë punësimit. Komunitat me koncentrim të lartë të komunitetit pakicë tregohet të jenë prapa në terma të zhvillimit ekonomik.

### Çështjet kyçe

Çështja kryesore është si të krijohet një zhvillim ekonomik i qëndrueshëm, jo vetëm në zonat e komunitetit pakicë, por përgjate shoqërisë së tërë. Një çështje tjetër është roli i ministrisë në këtë proces, siç është e qartë, ministria nuk mund të jetë drejtuesja kryesore e zhvillimit të tersishëm të shoqërisë.

Logjika prapa zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së komuniteteve kërkon një shumëllojshmëri të gjerë të iniciativave. Qasja e përgjithshme është të sigurohet zhvillim shoqëroro-ekonomik veçanërisht në komunitetet e marginalizuara duke zhvilluar komunitetin në aspektin e aftësisë të tyre për rregullimin shoqëroro-ekonomik, mbështetjen për shfaqjen e re sipërmarrëse dhe krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, dhe tërheqjen dhe mbajtjen e individëve të aftë .

Zhvillimi i komuniteteve tenton që të kërkojë aktivitetet e projektuara për të arritur mobilizimin e Komunitetit: nxitjen e zhvillimit dhe rritjes së komuniteteve duke mobilizuar ngritjen e vizioneve dhe hartimin e projekteve të natyrës lokale dhe rajonale. Ministria është duke ekzaminuar, së bashku me pjestarët e tjerë të qeverisë, qasjen e partneritetit të Bashkimit Europian. Ky mund të jetë një model i mirë ku komunitetet mund të mbledhen së bashku për hartimin e planeve lokale dhe strategjive që mund të nxisin financime. Programet që do të mbështeten përfshijnë ngritjen e strukturës ekonomike të komuniteteve përmes mbështetjes së ndërmarrësisë dhe krijimit të vendeve të punës.

Një qasje tjetër që qeveria e Kosovës është duke shqyrtuar është nocioni i zhvillimit ekonomik rajonal. Në Dhjetor të vitit 2008, u themeluan pesë Agjenci për Zhvillim Rajonal (AZhR). Një Institucion për Zhvillim Ekonomik Rajonal i BE-së (Institucioni EURED) është planifikuar të sigurojë synimin e asistencës efektive. Më 9 Mars 2009, ZNKE publikoi një Ofertë për propozime në një vlerë prej 2.5 milion Euro për mbështetjen e projekteve që mirren me zhvillim ekonomik në pesë rajone të Kosovës. Kjo pjesë e pakos për ndihmë i referohet fillimit të procesit rajonal zhvillimor në vend. AZhR-të do të ketë mbledhjen e parë të Bordit në Prill 2009 ku do të vendosen hapat e mëtejshëm të procesit të zhvillimit rajonal. Komisioni Evropian ka ndarë 6.6 milion Euro për periudhën 2009-2010 në mbështetjen e qasjes së zhvillimit ekonomik rajonal. Mbështetjet e mëtejshme është planifikuar për vitet 2011-2013.

Hulumtimi i bërë përmes projektit të BE-së për ngritjen e kapaciteteve në ministri ku është vlerësuar potenciali i komunave, veçanërisht i atyre që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në procese të tilla. Rezultatet tregojnë se

ekziston potenciali tek këto komuna për menaxhimin e projekteve të vogla deri tek ato me kapacitet të madhë. Në lidhje me këtë mund të ketë një argument për trajtim preferencial në respektimin e tenderimit. Kjo mund t'i limitoj numrin e atyre të cilët do të tenderojnë për projekte specifike në një listë me numër të vogël të njerëzve të përzgjedhur në mënyrë që të sigurohet se fondet janë synuar drejt zonave me nevoja më të mëdha. Siq shihet ky nuk do të jetë një proces afatshkurtër që u lejon komunave specifike rritjen dhe zhvillimin e tyre.

Një element tjetër po merret me diversifikimin e rajoneve ekonomike dhe komunitetet që kanë rritje të ngadalshme ekonomike dhe synon ato zona të cilat janë të prekura nga i ashtuquajtur i de-vitalizim (Aty ku ekonomia nuk ka funksion efektiv). Kjo zakonisht është trajtuar në kontekstin Evropian nga ajo që është quajtur Iniciativa për Diversifikimin Ekonomik të Komuniteteve. Kjo ndërlidhet me rindërtimin e komuniteteve duke krijuar fillimin e bizneseve të reja dhe zhvillimin e ndermarrjeve të vogla dhe të mesme, që mund të bazohen në industrinë dhe veprat artizanale tradicionale. Këto iniciativa janë synuar tek komunitetet që janë më shumë të prekura nga niveli i ulët i diversifikimit ekonomik apo ballafaqohen me sfidat si; pamjaftueshmëria e infrastrukturës në atë komunitet. Këto lloj iniciativa mund të mbështeten nga qasja drejt zhvillimit të komuniteteve në komunat e përzgjedhura me ndihmen e zyrtarëve të kualifikuar për zhvillim të komuniteteve që do të ndihmojnë në procesin e rindërtimit të komunitetit lokal.

### **Prioritetet në reformë**

Prioritetet kryesore janë:

- I. Të përmirësoj kapacitetin për stimulim të zhvillimit të mëtejshëm ekonomik në Kosovë, duke siguruar zhvillim e mundësive të barabarta për të gjitha komunitetet.
- II. Të sigurohet që fondet janë alokuar dhe plotësojnë kërkesat për stabilizim dhe integrim të komuniteteve, duke përfshirë të kthyerit.
- III. Të sigurohet shpërndarja e mjeteve sipas nevojave reale për stabilizimin dhe integrimin e komuniteteve, duke përfshirë të kthyerit.

Për arritjen e rezultateve nga prioriteti i parë, ministria ka shqyrtuar pozitën dhe rolin e saj sa i përket iniciativave të përgjithshme të zhvillimit ekonomik, për këtë ministria do të:

- i. Bashkëpunoj me ministritë relevante dhe agjencitë për promovimin e zhvillimit ekonomik dhe mundësive për punësim të synuar tek komuniteti pakicë
- ii. Të asistoj në promovimin e informatave të mundësive ekonomike si në nivel vendor ashtu edhe rajonal.

- iii. Ndarja e mekanizmave për të siguruar që kompanitë/organizatat në zonat e minoriteteve janë konkurruese në procesin e prokurimit të qeverisë.
- iv. Të bashkëpunoj me agjencitë relevante për promovimin e ndermarrjeve te vogla dhe te mesme në zonat e pakicave.
- v. Të bashkëpunoj me agjencitë tjera për programimin dhe alokimin e fondeve që synojnë nevojat e komuniteteve.
- vi. Të bashkëpunoj me ministrinë dhe agjencitë relevante për ndarjen e programeve trajnuese dhe projekteve që janë të drejtuara kah komunitetet.

Ministria do të vazhdojë të siguroj fonde për stabilizimin dhe zhvillimin e komuniteteve. Për të siguruar se fonde të tilla janë shpërndarë në mënyrë të duhur, ministria do të:

- i. Bëjë vlerësimin e nevojave të komuniteteve
- ii. Zhvilloj projekte apo iniciativa në linjë me nevojat e komuniteteve.
- iii. Ngris kapacitetin e komuniteteve për përpilimin dhe implementimin e projekteve.

Ministria është e njoftuar se krijimi i zhvillimit ekonomik është një çështje e ndërlikuar. Në të njëjtën kohë beson se këto politika do të fillojnë të adresojnë disa nga çështjet tek komunitetet. Gjithashtu beson se ministria do të jetë në një pozitë që të veproj si një institucion efikas që mbështetë zhvillimin ekonomik për të gjitha komunitetet, me një theks të veçant, si pjesë e përgjithshme e përpjekjeve të qeverisë, drejt komuniteteve pakicë.

## **VII. DREJTIMI DHE IMPLEMENTIMI**

Që ga themelimi i Minsitrisë për Komunitete dhe Kthim në vitin 2005, një pjesë e madhe e vëmendjes i është përkushtuar kthimit. Kjo ka qenë si pasojë e transferimit gradual të përgjegjësive nga UNMIK-u drejt qeverisë së Kosovës. Gjithashtu ishte rezultat i rritjes së njohurive dhe kapacitetit ekzistues në sektorin e kthimit.

Ministra për Komunitete dhe Kthim do të mbetet organi kryesor i qeverisë, përgjegjëse për implementimin e kësaj strategjie. Si pjesë e një rishikimi të përgjithshëm të veprimeve në të dy sektoret, për të cilat strategjia ofron një drejtim të përgjithshëm, ministria është duke ri-ekzaminuar organizimin e brendshëm të saj. Për arritjen e synimve që përcakton kjo strategji, do të paraqitet nevoja për forcimin e departamenteve të komuniteteve dhe kthimit,

duke suguruar që të kenë një staf me kapacitet dhe entuziazëm të mjaftueshëm. Prane kesaj pasi kjo strategji parasheh ngritjen e rolit të ministrisë në monitorimin dhe koordinimin e efikasitetit të ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë komunitetet, ku do të krijohet një njësi për krijimin e politikave apo për planifikim. Ekspertet e Ministrisë do të duhet të krijojnë organizatën e tyre të brendshme para perfundimit të vitit 2009.

## **Partnerët**

Ministria për Komunitete dhe Kthim mbetet marrësi kryesor në implementimin e strategjisë ku përveç kësaj, ekziston kërkesa për një koordinim në nivelin e qeverisë dhe institucioneve shtetërore si dhe partneret lokal dhe ndërkombëtar.

### **Institucionet qeveritare dhe shtetërore me përgjegjësi për çështjet e komuniteteve**

Ministria do të punoj për së afërmi me Zyrën për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për implementimin efektiv të kësaj strategjie. ZÇK është themeluar gjatë vitit 2008 për të këshilluar kryeministrin mbi çështjet specifike që i përkasin komuniteteve. ZÇK është përfshirë në zhvillimin e kësaj strategjie për të siguruar qeverisje dhe koordinim të mirë në shpërndarjen dhe zhvillimin e politikave.

Pas publikimit të planit të Ahtisarit për Kosovën dhe adoptimit të Kushtetutës në vitin 2008, Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK) është themeluar zyrtarisht në fillim të vitit 2009.

Këshilli Konsultativ për Komunitete, parasheh prane të tjerave edhe funksionet në vijim:

- T'i ofrojë komuniteteve mundësinë e pjesëmarrjes fillestare tek iniciativat për krijimin e legjislacionit dhe politikave, të përgatitura nga Kuvendi i Qeverisë, për të sugjeruar iniciativat të tilla dhe që të bëhet inkorporimi i pikëpamjeve të tyre në projektet dhe programet relevante, duke përfshirë strategjinë dhe raportin vjetor
- T'i mundësoj komuniteteve të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave të tyre, në krijimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve që u drejtohen pjesëtarëve të tyre dhe që kanë një relevancë të veçantë për ta.
- Të bëjë rekomandime gjatë procesit të vendim-marrjes që ka të bëjë me ndarjen e fondeve, si ato ndërkombëtare ashtu edhe ato të alokuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për ato projekte që u dedikohen komuniteteve apo interesave specifike të tyre

- Te ndikoj ne ngritjen e vetëdijes lidhur me brengat e komuniteteve ne Republiken e Kosoves dhe të kontribuoj në përmirësimin e marrëdhënjeve në mes të të gjitha komuniteteve ne Republiken e Kosoves.

Ministria do të punoj për së afërmi me KKK në implementimin e kësaj strategjie. Qeveria si tërësi beson se KKK ka një rol të rëndësishëm në monitorimin e efikasitetit të strategjisë dhe në dhënjen e rekomandimeve, kur paraqitet nevoja për modifikim apo përmirësim.

Ministria gjithashtu do të mbështetet në marrëdhënjen me Këshillin Parlamentar lidhur me të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Marrëdhënjet në mes të këshillit parlamentar kanë qenë gjithmonë të një natyre produktive dhe shpresohet që kjo do të zhvillohet më tej gjatë implemtimit të kësaj strategjie.

Së bashku me të gjitha institucionet qeverisëse dhe shtetërore me një mandat specifik që ka të bëjë me çështjet e komuniteteve, ministria për Komunitete dhe Kthim është duke kërkuar një marrëdhënie të mirë-koordinuar gjatë periudhës së planifikimit.

### **Ministritë tjera**

Siq është bërë e qartë nga qëllimet specifike të strategjisë, kërkohet një përpjekje për të koordinuar veprimin në mbështetje të komuniteteve. Përgjatë intervenimeve të shumta të qeverisë, ekzistojnë çështje që u përkasin komuniteteve në lidhje me ekonominë dhe zhvillimin e saj, shëndetësinë, arsimimin dhe çështjet sociale si dhe sigurinë. Dihet se nuk është vetëm detyrë e Ministrisë per Komunitete dhe Kthim të sjellë ndryshim në përmirësimin e këtyre fushave. Ministria do të kërkoj të punoj së bashku me ministritë dhe sektoret tjera për të siguruar se të gjitha komunitetet përfitojnë nga politikat që sjellin përmirësim të kushteve qofshin këto çështje që i përkasin ekonomisë, sigurisë apo çështjeve tjera. Kur ekzistojnë çështje specifike për shembull që kanë të bëjnë me asrimimin e komuniteteve apo të drejtat për përdorimin e gjuhës, ministria do punojë për së afërmi me ministritë relevante dhe institucionet qeveritare në mënyrë që të siguroj që politikat e duhura janë zhvilluar dhe implementuar. Në të njejtën kohë ministria do të vazhdojë të siguroj fonde për zhvillim specifik të komuniteteve dhe do të kërkoj të siguroj se përpjekjet e saj janë pjesë e iniciativave të qeverisë në zhvillimin e Kososvës.

### **Institucionet e sektorit të kthimit**

Ministria si institucion udhëheqës do të vazhdoj të koordinoj përpjekjet në sektorin e kthimit. Gjatë periudhës planifikuese të kësaj strategjie, ministria, siq u theksua në qëllimet e strategjisë do të kërkoj një qasje më të thjeshtësuar të kthimit. Ministria do të testoj ka fundi i vitit 2009 një metodë ku do bëhet ndarja e qartë

dhe më efektive e përgjegjësi në mes të akterëve të qeverisë qendrore dhe lokale. Lidhur me këtë ministria dëshiron të zhvilloj një marrëdhënje më të afërt dhe të zyrtarizuar dhe thëret të gjitha komunat të punojnë në mënyrë konstruktive për këtë përpjekje dhe të sigurojnë një përmirësim në këtë sektor. Ku është e mundur ministria do punoj për së afërmi me Ministrinë lidhur me këtë përpjekje. Detajet e një qasje më efektive në sektorin e kthimit janë pjesë e Manulalit të Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm dhe do të jenë temë e konsultave të gjera para se të bëhen efektive.

### **Organizatave lokale dhe ndërkombëtare**

Si në sektorin e kthimit ashtu edhe në atë të komuniteteve, ministri me këtë strategji parasheh të fuqizoj marrëdhënjet e saj si me partnerët lokal ashtu edhe me ata ndërkombëtarë. Si pjesë e pranimi se proceset e zhvillimit të komuniteteve dhe të kthimit janë mjaft komplekse dhe se qeverisë i duhet mbështetja e bashkëpunimi dhe përfshirjen me të thellë. Ministria, në emër të qeverisë, gjithashtu do të dëshirojë të njoh dhe është mirënjohëse për të gjitha veprimet pozitive të ndërmarra për të mbështetur procesin e kthimit dhe zhvillimin e komuniteteve në Kosovë dhe beson se mund të shikoj përpara për të rritur bashkëpunimin dhe mbështetjen gjatë zbatimit të kësaj strategjie.

### **Monitorimi dhe vlerësimi**

Një kërkesë kyçe e kësaj strategjie, së bashku me të gjitha strategjitë tjera që janë duke u hartuar nga qeveria është se janë të qarta mekanizmat për të siguruar se politikat e propozuara janë duke u implementuar në mënyrë efektive. Midis të tjerash qeveria ka nevojë që të siguroj se ka sisteme që mund të monitorojnë në mënyrë efektive procesin e zbatimit dhe se ekziston një mekanizëm llogaridhënës gjatë vlerësimit. Në këtë mënyrë do të ngrisin besimin në veprimet e qeverisë.

Kornizat Logjike të bashkangjitura si shtojca për të tre objektivat kryesore të politikave japin detaje për sistemet dhe procedurat e veçanta që do të vihen në vend nën rezultatet e dëshiruara dhe aktivitetëve ndihmëse. Në këtë tekst, ne do të dëshironim të nënvizojmë dy procedura specifike të monitorimit dhe vlerësimit që ministria do të nisë në fazën e parë të procesit të implementimit të strategjisë. Njëra është për kthimet e tjera për komunitetet.

Ne kuader të ministrisë do të formohet njesia për monitorimin e procesit të kthimit. Qëllimi i kësaj njesie-e cila me siguri do të vendoset në departamentet tani ekzistuese për kthim - është që të siguroj mbikqyrjen dhe monitorimin efikas të

projektit të kthimit. Me lëvizjen e ministrisë drejtë implementimit të mekanizmave më efektiv për kthimin, do të jetë në pozitë më të mirë të parasheh aspektet kualitative të procesit të kthimit. Baza prapa kësaj është si më poshtë. Sipas propozimeve për rregullime të reja, do të ketë një ndarje të qartë të përgjegjësisë për kthimet, ndërmjet qeverisë qendrore dhe lokale. Roli i pushtetit qendror do të jetë që të sigurojë fonde për kthimin e bazuar në aplikime nga të kthyerit potencial. Pas një aplikimi të suksesshëm, do të ketë një rol për zbatimin e veçantë të projekteve të kthimit. Roli i monitorimit do të jetë të mbikëqyr zbatimin e procesit duke pranuar raportet e mbarëvajtjes nga komunat dhe në bazë të marrëveshjes ku do të bëjë ndarjen e fondeve të mëtejshme në këtë proces. Për më tepër, njësia do të ketë rolin për kryrjen e kontroleve periodike mbi projektet që po zbatohen, në mënyrë që të bëjë ndarjen e problemeve në këtë fushë dhe të bëjë përpjekje për të siguruar që cilësia e punës është sipas standardeve të pranuar. Me ndarjen e elementeve të procesit të kthimit dhe ofrimin e një strukture më transparente, ministria beson se numri i kthimit do të rritet dhe se standarti i punës do të përmirësohet.

Lidhur me ndërhyrjet specifike të ministrisë për të siguruar fonde për zhvillimin e iniciativave të komunitetit, ajo domosdoshmërisht do të sigurojë që mekanizmat e përshtatshëm janë në vend për të vëzhguar specifikacionet e çdo projekti që e financon. Megjithatë, ministria beson se ka një kërkesë për një vlerësim të përgjithshëm të progresit, që duhet bërë në sektorin e komuniteteve. Kështu, si pjesë e kësaj strategjie, ministria nëpërmjet njësisë së politikave në bashkëpunim me Zyren për Qeshtjet e Komuniteteve prane zyres së kryeministrit, ta bëjë raportin vjetorë për "gjendjen e komuniteteve". Ky raport do të shqyrtojë ndërhyrjet e qeverisë lidhur me komunitetet dhe të përcjellë gjithë përparimin përgjatë çështjeve të shumta. Është parashikuar se dokumenti i parë i tillë do të jetë i prodhuar në vitin 2010 dhe ministria në shkallë të parë do të jenë mirënjohëse për ndihmën e trajnimeve të ofruara në këtë fushë. Synimi për një raport të tillë është jo vetëm për të siguruar një standart të komuniteteve, por edhe do të bënte të mundur për qeverinë të bëjë ndryshime në politika dhe ku është e nevojshme të ndihmojë në formulimin dhe rishikimin e kësaj strategjie. Qëllimi është se qeveria do të marrë në konsideratë çdo vit raportin dhe se do ta vë në dukje për miratim nga ana e parlamentit dhe Këshillit Konsultativ të Komuniteteve.

## **Financimi**

Në përgjithësi financimi për komunitetet do të ndahet nga natyra e tyre nga buxheti midis agjencive përkatëse zbatuese. Kushtetuta dhe ligjet e nderlidhura rekomandojnë që 12% e buxhetit të alokohen për komunitetet pakicë.

Në lidhje me buxhetin e propozuar për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, ekzistojnë vështirësi në projektimin e një buxheti të hollësishëm për një periudhë

katër vjeqare. Kjo ndodhë për shkak se pjesa më e madhe e buxhetit udhëhiqet nga kërkesa. E parë nga ana tjetër, ministria i përgjigjet, për shembull, kërkesave për kthime, kështu që shfrytëzon buxhetin e saj për një vit të dhënë. Ministria nuk mund të jetë e sigurtë lidhur me numrin e kthimit për çdo vit. Njëlloj, kur është fjala për komunitetet iniciativat zhvillimore kërkojnë ndihmë që tejkalon fondet e furnizimit. Gjatë vitit 2008, për shembull, ministria ka marrë kërkesa për financim me vlerë 12 milion euro, por kishte mundësi të alokonte vetëm të gjashtë pjesë të kësaj vlere.

Ministria pranon se në vitet e saj të veprimit kishte probleme të rëndësishme lidhur me shpërdarjen e buxhetit. Megjithatë, gjatë dy viteve të fundit ka pasur disa përmirësime. Megjithatë, ministria ka ende nevojë për të siguruar transparencë brenda operacioneve financiare. Duke pasur parasysh, gjatë vitit 2009, ministria do të instalojë mekanizma të përshtatshëm për të siguruar se operacionet e saj janë të lidhura në procesin e buxhetit.

Në vlerësimin e buxheteve të nevojshme për sektorët e kthimit dhe komuniteteve, qeveria dëshiron të falënderojë partnerët donatorë ndërkombëtarë që vazhdojnë të ofrojnë mbështetje me burimet shtesë për të dy sektorët.

### **Buxheti për Kthim**

Gjate viteve 2008 - 2009, ministria ka themeluar një numër të caktuar të grupeve punuese për të shqyrtuar procedurat e përfshira në procesin e kthimit. Nga dy grupe është kërkuar të mirren me specifikacionet e financimit në lidhje me shumën e alokuar për ndërtimin e pronave të bazuar në madhësinë e familjes dhe pakot ndihmëse që do jenë në dispozicion pas kthimit të familjeve. Të dy grupet kanë dhënë rekomandime në rishikimin e kostove të standardizuara që kanë të bëjnë me koston e ndërtimit dhe pakot e rishikuara ndihmëse. Ministria do të paraqes këto rekomandime në bord dhe t'i ndërtojë ato në kërkesat e saj buxhetore në të ardhmen. Këto kryesisht ndërlidhen me projektet e kthimit dhe shumën e alokuar për pronat.

Ministria edhe në të ardhmen dëshiron të financoj projekte për kthimin në grupe. Projektet do të bazohen në kërkesat për kthim të parashtruara nga ana e personave të zhvendosur, në baze të cilës ministria do të ofrojë mbështetje grupeve të kthehen në vendin e tyre të origjinës. Kjo është për shkak se nëse hartohen dhe zbatohen në mënyrë të përshtatshme ato ofrojnë ekonomitë e shkallës dhe çojnë në rritje të numrit të kthimit. Këto projekte do të implementohen nga komunat, varësisht nga aplikacionet e pranuar. Për të vendosur për projektet që do të implementohen ministria do të ndërlidhë procesin për së afërmi me ciklin e buxhetit. Ministria do të bëjë zëvendësimin e mekanizmave ekzistues, siq është Mekanizmi Qëndror i Rishikimit dhe Këshilli për Alokimin e Buxhetit. Në vend të tyre do të ekzistoj një këshill i përbërë kryesisht nga anëtarë të qeverisë për të vendosur për aplikacionet e pranuar. Detajet tjera

për propozimin e rregullimeve të reja do t'u dërgohen komunave në dokumente të veçanta.

### **Buxheti për Komunitetet**

Buxheti për komunitetet, sikurse më parë, do të jetë i bazuar tek aplikacionet e përshtatshme të marra nga projektet për zhvillim të komuniteteve. Projekte të tilla mund të rrjedhin nga komunat, nga vullnetarët dhe sektori privat. Gjatë vitit 2009, ministria do të angazhohet për vlerësimin e nevojave të komunitetit, në mënyrë që të vlerësoj se ku duhet shpërndarë fondet qeveritare. Në përgjithësi, ministria dëshiron të financoj iniciativat që çojnë në stabilitetin e komuniteteve dhe zhvillimit të gjerë ekonomik dhe mundësitë e punësimit në mesin e komuniteteve pakicë. Në financimin e projekteve të tilla, ministria do të kërkoj mbështetje nga donatorët dhe sektori privat për zhvillimin që mund të çoj në ndryshimin vendimtar midis komuniteteve. Në veçanti, ministria është e interesuar në mbështetjen e projekteve për ndërmarrjet e vogla dhe gjithashtu gjatë kohëzgjatjes së strategjisë për ndërmarrjet e mesme, që kanë më shumë mundësi për krijimin e vendeve të punës.

### **Buxhetet tjera**

Buxhetet normale të operimeve - duke përfshirë pagat, shpenzimet periodike të shërbimeve do të jenë subjekt i shpeshtë i kërkesave të përgjithshme dhe kufizimeve në kuadër të qeverisë. Sipas kësaj, duhet të dihet se ministria si pjesë e qeverisë paraqet institucionin përgjegjës me mandat specifik, dhe net e mund të testohen iniciativat reforme në sektorin publik në lidhje me zbatimin e pageses perkatese. Sa i perket vendosjes së njesise politiko/planifikuese, ministria do të mbaje buxhetin për hulumtimin ku mund t'i harrgjoj njohuritë e saj për nevojat e komuniteteve dhe zgjidhjeve eventuale të problemeve ekzistuese.

Një anë tjetër e punës së ministrisë është aftësia e saj për t'u përgjigjur emergjencave, gjatë ngjarjes. Shumë nga kjo strategji do të çojë në transformimin e formës së ministrisë në një institucion që u përgjigjet krizave, në një institucion që është proaktiv dhe bënë planifikime strategjike për të ardhmen, sidoqoftë ekziston një kërkesë për emergjencat e paparashikuara. Lidhur me këtë ministria do të krijoj një fond fleksibil për ministrin, në mënyrë që qeveria të jetë në pozitë t'u përgjigjet emergjencave kur vije deri te ato.

## VIII. KONKLUZIONET

Ministria për Komunitete dhe Kthim në emër të qeverisë së Kosovës ka nderin të prezantoj drejtimet e politikave strategjike të qeverisë për periudhën 2010-2014.

Përmbledhja e synimeve kryesore të politikave të strategjisë është që të:

- I. Siguroj kushte për kthim të qëndrueshëm përmes një sistemi të thjeshtësuar
- II. Të përmirësoj mundësitë lidhur me arsimimin, përdorimin e gjuhëve, qasjen në shërbimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe sigurinë për grupet komunitare që siguron stabilizimin, fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve
- III. Përmirësimi i kushteve ekonomike dhe integrimi i komuniteteve, duke përfshirë të kthyerit, ku promovohet një Kosovë stabile, demokratike, prosperuese dhe multietnike.

Qeveria beson se këto synime dhe aktivitetet e ndërlidhura do të përmbushen plotësisht siq janë theksuar në këtë dokument dhe detajuar në shtojcat e kësaj strategjie do të çojnë në një situatë të përmirësuar në procesin e kthimit dhe një jete më të mirë për të gjitha komunitetet brenda vendit.

Qeveria, nëpërmjet Ministrisë për Komuniteteve dhe Kthimit pret që të punojë me të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët e saj në realizimin e këtyre qëllimeve në vitet e ardhshme.

## **INSTRUMENTET JURIDIKE**

Kushtetuta e Kosovës 17.03.2008

Ligji mbi formimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronësisë së Patundshme 2002/05 i vitit 2002

Ligji për Kooperativat Bujqësore 2003/9 data 15.05.2003

Ligji mbi Rrugët 2003/11 i datës 25.05. 2003

Ligji mbi amandamentet dhe shtojcat e Ligjit nr. 2002 / 5 për formimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronësisë së Patundshme 2003/13 nga 26/06/2003

Ligji mbi Kadastrën 2003/25 nga 04.12.2003

Ligji mbi Planifikimin Hapësinor 2003/14 nga 03.07.2003

Ligji mbi Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë 2003/15 nga 11.07.2003

Ligji mbi Regjistrimin e Popullsisë dhe Strehimit në Kosovë 2003/16 nga 11/07/2003

Ligji për Siguri, Shëndetësisë profesionale dhe Mjedisit të punës 2003/19 nga 09/10/2003

Ligji i Kosovës mbi Pensionet Invalidore 2003/23 nga 06.11.2003

Ligji mbi Barazinë Gjinore 2004/2 nga 19.02.2004

Ligji mbi Anti-diskriminimin 2004/3 nga 19.02.2004

Ligji mbi Shëndetësinë 2004/4 nga 19.02.2004

Ligji mbi Energjetikën 2004/10 nga 29.04.2004

Ligji mbi Trashëgiminë 2004/26 nga 28.07.2004

Ligji për Shtypjen e Korrupsionit 2004/34 nga 22.04.2005

Ligji mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor 2004/38 nga 08/09/2004

Ligji për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme 2005/02-L5 nga 23.03.2005

Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare 2005/02-L17 nga 21.04.2005

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve 2005/02-L24 nga 22.07.2005

Ligji për Token Bujqësore 2005/02-L26 nga 24.06.2005

Ligji për Procedurën Administrative 2005/02-L28 nga 22.07.2005

Ligji mbi edukimin Parashkollor 2006/02-L52 nga 19.01.2006

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve 2006/02-L37 nga 27.07.2006

Ligji për Liritë Fetare 2006/02-L31 nga 3.07.2006

Ligji për Trashëgimin Kulturore 2006/02-L88 nga 09.10.2006

Ligji për Shëndetësi Publike 2007/02-L78 nga 22.02.2007

Ligji për Emrin Personal 2007/02-L118 nga 13.04.2007

Ligji për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin 2007/02-L121 nga 27.09.2007

Ligji mbi Shtetësinë 2008/03-L034 nga 15.06.2008

Ligji për Policinë 2008/03-L035 nga 20.02.2008

Ligji mbi vetë qeverisjen lokale 2008/03-L040 nga 20.02.2008

Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës 2008/03-L047 nga 15.06.2008

Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës 2008/03-L068 nga 15.06.2008

Ligji për Përkrahjet Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme 2008/03-L022 nga 16.05.2008

Ligji për Procedurën Kontestimore 2008/03-L006 nga 30.06.2008

Ligji për zgjedhjen e kërkesave lidhur me pronën e pa luajtshme, duke përfshirë edhe pronën bujqësore dhe komerciale 2008/03-L079 nga 13.06.2008

## **INSTRUMENTET JURIDIKE NDERKOMBETARE**

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999 )

Korniza Konventë për mbrojtjen e minoriteteve nacionale (1994)

Parimet për rikthimin e Objekteve të Strehimit dhe Pronës Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur, Parimet nga Pinheira (2005)

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale (1950)

Karta evropiane për gjuhët rajonale apo të pakicave (1994)

Karta shoqërore Evropiane- rishikuar (1996) e cila është nënshkruar po ende nuk është ratifikuar

Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe degradimit çnjerëzor ose trajtimit ndëshkues (1987)

Protokolli që parandalon dhe denon, personat që mirren me trafikimin e qenjeve njerëzore në veçanti të grave dhe fëmijëve, së bashku Konventa mbi Krimin e Organizuar, Protokollin e Palermos (2000)

Deklarata e Bolonjës në Hapësirën Evropiane për Arsim të Lartë, "Deklarata e Bolonjës" (1999)

Konventa Evropiane për Njohjen Akademike të Kualifikimeve Universitare (1959)

Konventa e Këshillit Evropian për Njohjen e Diplomave për hyrjen në Universitete (1953) dhe protokolet e saj (1964)

Konventa Evropiane mbi Njohjen e Ciklit të studimit Universitar (1956)

Konventa Evropiane mbi Njohjen e Ciklit të studimit Universitar (1990)

Konventa Evropiane për Njohjen e Kualifikimeve të Edukimit të Lartë brenda Rajonit Evropian (1999)

Konventa Evropiane për Njohjen e Kualifikimeve të Edukimit të Lartë brenda Rajonit Evropian (1979)

Zona Evropiane e Arsimit të Lartë, Qëllimi i zbatimit, komunikata e Konferencës Evropiane të Ministrave Përgjegjës për Arsimin e Lartë, Bergen (2005)

Protokolli fakultativ së bashku me Konventën për zhdukjen e të gjitha llojeve të diskriminimit ndaj grave(2000)

Deklarata nga Kopenhagen e Ministrave Evropian për Arsimimin dhe specializimin profesional lidhur me Çështjet e Bashkëpunimit Evropian në Fushën e Arsimit dhe Specializimit Profesional (2002)

Komunikata e Londrës (2007)

MAGNA CHARTA UNIVERSITATUM - Karta e Bolonjës (1988)

Formësimi i Euro Hapësirës për Arsim të Lartë, Mesazh nga Salamanca (2001)

Arsimimi për të gjithë (Arsimimi për të gjithë - EFA), Korniza e Veprimit Dakar (2000)

Implementimi i Euro Hapësirës për Arsim të Lartë, komunikatë e Konferencës së Ministrave për Edukim të Lartë Berlin (2003)

Rezoluta për fuqizimin dhe bashkëpunimin e Arsimit dhe Specializimit Profesional (2002)

Deklarata e unifikuar për harmonizimin e Sistemit Evropian të Strukturës së Arsimit të Lartë, Deklarata e Sorbonës (1998)

Marrëveshjet ndërkombëtare (bilaterale) për siguri shoqëore nga konventa e Gjenevës I-IV në mbrojtjen e viktimave të luftës (1949) dhe Protokolet shtesë I-II (1977)

Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijëve (1989)

Konventa e KB për të Drejtat dhe Statusin e Refugjatëve (1951) dhe Protokolet Shtesë (1967)

Konventa e KB për mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Emigrantë dhe pjestarëve të familjeve të tyre (1990)

Konventa e KB kundër Diskriminimit në Arsimim (1960)

Konventa e KB kundër Torturës dhe proceduarve tjera mizore, jo-humane dhe ndëshkimeve (1984)

Konventa ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (1968)

Pakti i KB mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966) dhe protokolet opsionale (1966 dhe 1968)

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)

Parimet udhëheqëse për Zhvendosjen e Brendshme (1998).

## SHTOJCA A

### KORNIZA LOGJIKE PER KTHIM TE QENDRUESHEM

Objektivat e përgjithshme: synimi dhe vizioni	Indikatorët objektivisht të verifikueshëm	Burimet e verifikimit	Rreziqet dhe Supozimet
Të kontribuoj drejt zhvillimit të një shoqërie multi-etnike, prosperuese dhe demokratike me të drejta të barabarta			
Qëllimi i objektivave specifike/strategjike/operative	Indikatorët objektivisht të verifikueshëm (si të bëhet vlerësimi nëse ndodhë)	Burimet e verifikimit (sistemet raportuese)	Reziqet dhe Supozimet (eksterne dhe interne)
Të sigurohet se kushtet për kthim të qëndrueshëm ekzistojnë dhe mundësojnë integrimin e personave në shoqërinë e Kosovës	<p>Numri i të kthyerve (rritje nga numri i synuar në vitin 2008)</p> <p>Marredheniet e numrit të personave që janë kthyer dhe numri i personave që qëndrojnë ende në Kosovë edhe pas tri viteve të kthimit</p> <p>Per me pak se 70% te te kthyerve te interesuar potencial jane bere vleresimet per ndihma per kthim sipas kriterëve per kthim permes komunes ose MKK-se.</p>	<p>Statistikat e MKK-së dhe Qeverisë si dhe UNHCR-it, hulumtimi dhe raportet, Informatata e departamenteve dhe futja e kontakteve nga ana e departamenteve.</p>	<p>Kufizimet Buxhetore</p> <p>Periudha e gjatë për implementim</p> <p>Përbushja e detyrave</p> <p>Përkushtimi politik</p>
Rezultatet/outputet	Indikatorët objektivisht të verifikueshëm	Burimet e verifikimit	Rreziqet dhe Supozimet
1. Themelimi i mekanizmeve të përmirësuar dhe të	Zhvillimi i masave që sigurojnë	Raportet e Menaxhmentit	Jofunksionaliteti i revidimit te

<p>thjeshtësuar për kthimet</p> <p>Formimi i bazës së të dhënave që përmbanë evidencen e atyre te cilet jane paraqitur per kthim, dhe te gjitha informacionet te cilat kane te bejne ne ndihmen per kthim.</p>	<p>procedurat efektive dhe të gatshme për qasje që lejojnë procesimin e aplikacioneve brenda afatit sa me te shkurter kohore.</p>	<p>Raportet e MKK-së</p> <p>Anketat mbi kënaqshmërinë e klientit</p> <p>Procesimi i regjistrimeve dhe statistikave</p>	<p>mekanizmave per kthim.</p> <p>Mungesa e përkushtimit politik</p> <p>Mungesa e fondeve</p>
<p>2.Bartja e informacioneve tek personat e shperngulur lidhur me mekanizmin e ri per kthim si dhe per kushte</p>	<p>Zhvillimi i një sistemi komunikues të integruar komunikativ I cili saktësisht ka per qellim personat e shperngulur dhe siguron qe 80% te rasteve dhe informacioneve jane te pranuar dhe te kuptuara.</p>	<p>Dokumenti i kontraktuar lidhur me harmonizimin e komunikimeve (Strategjia per Komunikim).</p> <p>Kthimi i Informatave nga klienti</p> <p>Të dhënat nga hulumtimi</p> <p>Procesverbalet e mbledhjeve</p>	<p>Mungesa e bashkepunimit nga ana e partnereve ne kuader te trashigimise se informacioneve</p>
<p>3.Pakoja e ndihmave per te kthyerit eshte siguruar sipas standardeve te pranuar unike.</p>	<p>Vendosja dhe ndihma per reintegrim eshte mundesuar sipas nevojave te perbashketa unike dhe standardeve.</p>	<p>Raportet per monitorim</p> <p>Raportet e anketimit</p> <p>Kthimi i Informatave nga klienti</p>	<p>Mungesa e mjeteve</p>
<p>4.Ndihma per kthim dhe reintegrim eshte ofruar per grupet te zgjeruara te shfrytezuesve nga mjetet e PZHI-se dhe PZHII-se.</p>	<p>Numri i te kthyerve</p> <p>Numri i te interesuarve per kthim</p> <p>Programi i zgjeruar i grupeve te shfrytezuesve per ndihma</p>	<p>Statistikat dhe raportet</p>	<p>Mungesa e mjeteve</p> <p>Perkushtimi politik</p>
<p>5.Të kthyerit në zonat urbane janë në avantazhë në krahasim me të kthyerit në zonat rurale për shkak të mundësive më të mira dhe integritit më të lehtë të të kthyerëve (ne vendet ku ka qasje ne shkolla, institucione shendetesore, etj., ne vendet net e cilat ekziston niveli I caktuar I infrastructures).</p>	<p>Zhvillimi i procedurave dhe sistemeve mbështetëse që synojnë një nivel të lartë të mbështetjes për njerëzit që kthehen në zonat urbane</p>	<p>Raportet</p> <p>Auditimi i sistemeve</p> <p>Kthimi i Informatave nga klienti</p> <p>Statistikat</p> <p>Raportet e publikuara dhe ato të</p>	<p>Bashkepunimi ne komuna</p> <p>Mungesa e mjeteve</p>

		ministrisë	
		Manuali	
<b>Aktivitetet që duhet arritur si rezultatet</b>	<b>Indikatorët objektivist të verifikueshëm</b>	<b>Burimet e verifikimit</b>	<b>Rreziqet dhe Supozimet</b>
<p>Aktivitetet e rezultatit një:</p> <p>a. Revizionimi dhe standardizimi i procedurave për kthim përfshirë rishikimin e manualit për kthim të qëndrueshëm.</p> <p>b. Adoptimi i procedurave të standardizuara</p> <p>c. Bashkëpunimi me komunat për të qartësuar çështjet e pronave.</p>	<p>Doracaku I reviduar per kthim te qendrueshem deri ne fund te vitit 2009.</p> <p>Bashkepunim me komuna</p>	<p>Eshte aprovuar Doracaku i reviduar</p> <p>Raporti i procedurave</p> <p>Mbledhjet e departamenteve dhe procesverbalet</p> <p>Procesverbalet e mbledhjeve</p>	<p>Bashkepunim me komuna</p> <p>Mungesa e mjeteve</p> <p>Perkujdesja politike</p>
<p>Aktivitetet e rezultatit dy:</p> <p>a. Strategjia e koordinuar e komunikimit dhe fushatave mediale per ngritjen e vetdijes se Ministrise brenda grupeve te saj klientale</p> <p>b. Implikimi lidhur me strategjine dhe komunikimin e Ministrise</p>	<p>Kampanja në media që ngritë perceptimin publik dhe ngritë emrin (perceptimi i njohurive deri në 75%) deri në fund të vitit 2010</p> <p>Faqja e Internetit e përmirësuar (numri i vizitorëve)</p> <p>Qendrave për thirrje është vuar ne nivel te MKK-se gjate vitit 2010</p>	<p>Raporti hulumtues</p> <p>Raporti mbi strategjinë e komunikimit për MKK-në</p> <p>Kthimi i Informatave nga klienti</p> <p>Të dhënat e faqes së internetit</p> <p>Anketat mbi nivelin kënaqshmërinë e përdoruesve</p> <p>Profilet e përdorimit për klientë</p>	
<p>Aktivitetet e rezultatit tre:</p> <p>a. Implementimi I ndihmes per kthim dhe riintegrimin ndaj standardeve te reviduara dhe te aprovuara si dhe procedurave.</p> <p>b. Rekonstruimi i shtëpive dhe nderlidhja urgjente e rrjetit infra-strukturore.</p>	<p>Shtepite e ndertuara ne pajtueshmeri te caktuar</p> <p>Eshte siguruar "pakoja complete" e ndihmave per te kthyerit dhe per riintegrim.</p>	<p>Raporti i statistikes banesore</p>	<p>Mungesa e mjeteve</p> <p>Perkujdesja politike</p>

<p>Aktiviteti per rezultatin e katert:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Zgjerimi i grupeve te perfituesve me kriteriumet e reviduara lidhur me ndihmat gjate kthimit</li> <li>b. Pergaditja per mbylljen e qendrave kolektive</li> </ul>	<p>Revidimi i kriteriumeve per ndihma per kthim</p> <p>Mbyllja e disa qendrave kolektive deri ne vitin 2012</p>		
<p>Aktivitetet per rezultatin e peste</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Analiza e nevojave dhe zhvillimi i programeve te cilat ndihmojne kthimin ne mjediset gjysme-urbane</li> <li>b. Implementimi i programit i cili ndihmon kthimin ne vendbanimet gjysme-urbane.</li> </ul>			

## SHTOJCA B

### MASAT LIGJORE PER KOMUNITETET PAKICE DHE PERFORCIMI I KORNIZES LOGJIKE

Objektivat e përgjithshme: synimi dhe vizioni	Indikatorët objektivisht të verifikueshëm	Burimet e verifikimit	Rreziqet dhe Supozimet
Të kontribuoj drejt zhvillimit të një shoqërie multi-etnike, prosperuese dhe demokratike me të drejta të barabarta			
Qëllimi I objektivave specifike/strategjike/operacionale	Indikatorët objektivisht të verifikueshëm	Burimet e verifikimit	Rreziqet dhe Supozimet
<p>Përmirësimi i mundësive në fushat në vijim</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Arsimitimi i duhur për grupet e komunitetit pakicë</li> <li>2. Përmirësimi i respektimit të përdorimit të gjuhës për të gjitha grupet komunitare</li> <li>3. Qasja e përmirësuar në shërbimet shoqërore dhe shëndetësore për komunitetet pakicë (duke përfshirë të kthyerit)</li> <li>4. Situata e përmirësuar e sigurisë për grupet pakicë</li> <li>5. Kualiteti i lartë i zbatimit të Ligjit për Komunitete në jetën e përditshme për të siguruar stabilizim, fuqizim dhe zhvillim të komuniteteve</li> </ol>	Statistikat ndërkombëtare dhe krahasimi me standardet e BE-se dhe standardet tjera ndërkombëtare	<p>Raporti nacional</p> <p>Raporti projektues</p> <p>Raporti mbi stabilizimin</p>	

Rezultati/output	Indikatorët objektivisht të verifikueshëm	Burimet e verifikimit	Rreziqet dhe Supozimet
1. Kapaciteti i përmirësuar për zhvillimin dhe fuqizimin e ligjeve, rregulloreve dhe standardeve në lidhje me sigurinë, arsimin, shërbimet shoqërore dhe shëndetësore dhe përdorimin e gjuhës.	Lëvizja drejt standardeve të BE-së dhe kritetret ndërkombëtare që reflektojnë një komunitet stabil	Raportet Raportet ndërkombëtare dhe ato krahasuese të vendit	Adoptimi dhe zhvillimi i rregulloreve nga ana e institucioneve përgjegjëse të qeverisë Përfshirja e komunitetit pakicë në programe dhe prioritetet e nivelit të lartë
2. Ngritja e vetëdijes në mes të pjestarëve të komuniteteve lidhur me vlerat e një shoqërie multietnike, demokratike, prosperuese, dhe të barabartë dhe të sigurohet përfaqësim i barabartë i të gjitha komuniteteve në jetën publike Ndhima direkte e siguruar për stabilizim të komuniteteve	Treguesit e një komuniteti stabil Numri i forumeve mbi komunitetet të cilat janë të hapura dhe të cilat funksionojnë	Treguesit ndërkombëtar dhe vendor të statistikave Raportet Raportet kombëtare Raportet e forumeve	
Aktivitetet që duhet arritur rezultatet	Indikatorët objektivisht të verifikueshëm	Burimet e verifikimit	Rreziqet dhe Supozimet
Aktivitetet e rezultatit një: a. Zhvillimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe sektorin e drejtësisë. b. Hartimi i propozimit të projektit lidhur me sigurinë për Keshillim e Kosoves për Siguri. c. Bashkëpunimi me ministrinë lidhur me arsimin, shëndetësinë dhe mirëqenjen sociale d. Forcimi i bashkëpunimit me komunitatet e. Forcimi i bashkëpunimit me ministrinë "horizontale" siq janë ministria e financave, qeverisjes lokale	Marrëveshjet bashkëpunuese Marrëveshja e nënshkruar lidhur me bashkëpunimin Formimi i partneritetit lokal Bashkefinancimi i projekteve të cilat kontribuojnë për Komunitete në Kosovë	Raporti i rekomandimeve Dokumenti i politikave të MKK Procesverbalet e mbledhjeve Raportet Publikimi i zbulimeve Raportet e mbledhjeve Publikimet Dokumentet qeveritare	Bashkëpunimi i ministrive përgjegjëse IPA/financimi nga donatorët

<p>f. Forcimi i bashkëpunimit me agjencitë qeveritare në veçanti me zyrën e statistikave dhe Agjencinë Kosovare të Pronës</p> <p>g. Rishikimi i efikasitetit të mekanizmave ekzistues për Komunitetet dhe propozimi për mekanizma efektiv për bashkëpunim ndër qeveritar</p> <p>h. Themelimi i njësisë për planifikim të politikave në ministri</p> <p>i. Inkurajimi i pjesëmarrjes të grupeve të komunitetit pakicë në formulimin e politikave:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bashkëpunimi gjatë punës me KKK</li> <li>2. Hulmtimi dhe rekomandimi i metodave për komunikim më efektiv dhe konsulencë me komunitetet në nivel komunal</li> </ol>			
<p>Aktivitetet e rezultatit dy:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Zbatimi i projekteve hulmtuese dhe bashkëpunimi për publikimin e raporteve nacionale mbi qeshtjet e veqanta në lidhje me komunitetet pakice.</li> <li>b. Organizimi dhe pjesëmarrja në konferenca dhe ngjarje të tjera publike në Kosovë dhe rajon për promovimin e bashkëpunimit</li> <li>c. Forcimi i bashkëpunimit me ministrinë e shërbimeve publike dhe agjencitë tjera qeveritare siq është ombsupersoni dhe komisioni i mediave.</li> <li>d. Komunikimi direkt me komunitete</li> <li>e. Financimi dhe implementimi i projekteve të cilat kanë për qëllim stabilizimin e komuniteteve</li> </ol>	<p>Organizatat e bashkangjitura nderkombetare</p> <p>Pjesëmarrja në seminar r</p> <p>Formimi i grupeve punuese</p> <p>Kriteriumet dhe procedurat për implementimin duke kyqur edhe zhvillimin e mekanizmave për bashkëpunim dhe implementim</p> <p>Numri i projekteve të sukseshme</p>	<p>Raportet e MKK-së</p> <p>Raportet buxhetore</p> <p>Procesverbalet e mbledhjeve</p> <p>Marrëveshjet</p> <p>Rezultatet hulmtuese</p> <p>Anketat lidhur me kenaqesin e shfrytëzuesve të projekteve</p> <p>Publikimet</p> <p>Dokumentat qeveritare</p> <p>Procesverbalet nga konferencat dhe seminarat</p>	<p>Kufizimet buxhetore</p> <p>IPA/financimi nga donatorët</p>

## SHTOJCA C

### KORNIZA LOGJIKE PER ZHVILLIMIN EKONOMIK TE KOMUNITETEVE PAKICE

Objektivat e përgjithshme-synimi dhe vizioni	Indikatorët objektivisht të verifikueshëm	Burimet e verifikimit	Rreziqet dhe Supozimet
Të kontribuoj drejt zhvillimit të një shoqërie multi-etnike, prosperuese dhe demokratike me të drejta të barabarta			
Qëllimi I objektivave specifike/strategjike/operacionale	Indikatorët objektivisht të verifikueshëm	Burimet e verifikimit	Rreziqet dhe Supozimet
Përmirësimi I kushteve ekonomike dhe integrimi I komuniteteve, duke përfshirë të kthyerit që promovon një Kosovë stabile, demokratike, prosperuese dhe multi-etnike	Krijimi I mikro fondeve për NVM në MKK Krijimi I skemës për zhvillimin e komuniteteve e ndihmuar nga qasja për zhvillim të komuniteteve	Grantet/Huatë Të dhënat për NVM e ndihmuara Kriteret shpërblyese Raportet CD	Buxheti I qasur Bashkëpunimi ndërministror Bashkëpunimi me partneret nderkombetar
Rezultatet / outputet	Indikatorët objektivisht të verifikueshëm	Burimet e verifikimit	Rreziqet dhe Supozimet
1. Përmirësimi i kapacitetit për stimulim të mëtejshëm ekonomik në Kosovë, sigurimi i zhvillimit të mundësive të barabarta për të gjitha komuniteteve. 2. Alokimi I fondeve që plotësojnë kërkesat për stabilizim dhe integrim të komuniteteve, përfshirë të kthyerit.	Fondet e mundshme nga donatorët/buxheti kombëtar dhe fondet nën kontrollin e MKK	Raportet e menaxhmentit Raportet hulumtuese Llogaritë e audituara Raportet Grantet e lejuara	Buxheti i qasur Gatishmëria për bashkëpunim nga ministrinë tjera

Aktivitetet për arritjen e rezultateve	Indikatorët objektivisht të verifikueshëm	Burimet e verifikimit	Rreziqet dhe Supozimet
<p>Aktivitetet e rezultatit një:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Bashkëpunimi me ministritë relevante dhe agjencitë për promovimin e punësimit dhe zhvillimit ekonomik që synojnë komunitetet pakicë</li> <li>b. Asistimi në promovimin e mundësive ekonomike si në nivel vendor ashtu edhe rajonal</li> <li>c. Te rekomandojnë që kompanitë/organizatat në fushën e minoriteteve janë konkurruese në procesin e prokurimit të qeverisë</li> <li>d. Bashkëpunimi me agjencitë relevante për promovimin e NVM në rajonin e minoriteteve</li> <li>e. Bashkëpunimi me agjencitë tjera për programimin dhe alokimin e fondeve që synojnë nevojat e komunitete</li> <li>f. Bashkëpunimi me ministritë relevante dhe agjencitë për ndarjen e programeve trajnuese dhe projekteve që synojnë komunitetet</li> </ul>			
<p>Aktivitetet e rezultatit dy:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Vlerësimi i nevojave të komuniteteve</li> <li>b. Zhvillimi i projekteve apo iniciativave në vijë me nevojat e komuniteteve.</li> <li>c. Ngritja e kapacitetit të komuniteteve për përpilimin dhe implementimin e projekteve.</li> </ul>			

